

# FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR

## SHQIPËRI

### **Konsultimet e Artikullit IV të 2010**

### **Konkluzionet Paraprake të Misionit**

10 Mars 2010

#### ***Stimuli i fortë i politikave ekonomike zbuti goditjen e krizës botërore...***

1. Përballë stuhive të forta, ekonomia shqiptare e ka përballuar krizën botërore mjaftueshëm mirë deri tani. Megjithë rënien e fortë ekonomike dhe goditjen e besimit në pjesën më të madhe të Europës dhe në ekonomi të tjera të përparuara, si dhe rëniet në eksporte dhe në dërgesat e emigrantëve, prodhimi i brendshëm bruto (PBB) i Shqipërisë, vlerësohet të ketë regjistruar një rritje prej 3 përqind në vitin 2009. Për më tepër, besimi në sektorin financiar është rikthyer siç provohet nga rifillimi i rritjes së depozitave. Në të njëjtën kohë pritshmëritë e inflacionit kanë mbetur të mirëankoruara, ndërsa dërgesat e emigrantëve dhe eksportet kanë filluar të marrin veten.

2. Stimujt fiskalë dhe monetarë kanë qenë një faktor i rëndësishëm në shpjegimin e kësaj ecurie ekonomike të favorshme. Funkzionimi i plotë i stabilizatorëve automatikë të buxhetit—kryesisht ulja e të ardhurave—u shoqërua me rritje të mëdha në shpenzime. Politika monetare ofroi ndihmesë në kohën e duhur nëpërmjet dy uljeve të normës bazë të interesit dhe injeksioneve të likuiditetit, ndërsa kursi i këmbimit kreu funksionin e tij si absorbues goditjesh. Tradita e një mbikqyrjeje dhe regullimi i matur ndihmuan të garantonin që bankat të hynin në krizë në formë të mirë dhe të mund të mbështeteshin në rezerva të konsiderueshme kapitali dhe likuiditeti. Këto u mbështeten më tej dhe nga ndihma e bankave të huaja mëma. Për më tepër, ndikimi i krizës u zbut nga pesha e kufizuar e kanlit të eksporteve në Shqipëri dhe mbështetja e tij e vogël në financime nga tregu.

#### ***...por tani mekanizmat mbrojtës duhen rindërtuar dhe politika fiskale duhet shtrënguar në mënyrë që të ruhet stabiliteti makroekonomik i vazhduar***

3. Stimuli fiskal tashmë është bërë një rrezik, pasi rëndon dobësitë ekzistuese. Defiçiti fiskal, i cili ka qenë rreth 3 përqind e PBB-së deri në 2007, është ngjitur në 7 përqind që atëherë, pasi rritja e madhe e shpenzimeve ka kaluar mbledhjen e të ardhurave—megjithëse të ardhurat nga privatizimet kanë kufizuar nevojat për huamarrje. Ky ka qenë një faktor i rëndësishëm në rritjen e borxhit publik në afër 60 përqind të PBB-së dhe në 2009 shkaktoi akumulimin e vonesave në shlyerjen e shpenzimeve në masën 0.4 përqind të PBB-së. Kryesisht i nxitur nga këto faktorë, defiçiti i llogarisë korente arriti 15% në 2009, një nivel përtej burimeve të parashikuara të ardhme të financimit. Këto prirje rrezikojnë të kufizojnë

hapësirën për investime private dhe qëndrueshmërinë e borxhit. Për më tepër, rezervat në sektorin financiar kanë nevojë për forcim të mëtejshëm për të përballuar sfidat e reja dhe për të krijuar mundësitë për një rifillim të qëndrueshëm të rritjes së kreditimit.

4. Mjedisi i jashtëm mbetet sfidues. Rimëkëmbja botërore po ecën me ritme të ndryshme në rajone të ndryshme, dhe rritja ekonomike në vendet e industrializuara dhe në Europë parashikohet të mbetet e ngadaltë dhe [shumë e varur nga stimuli i politikave](#). Ndërkohë situata në tregjet financiare botërore, megjithëse po përmirësohet mbetet [e brishtë në shumë vende të përparuara](#). Kohët e mira të viteve të bumit ekonomik janë tashmë një gjë e së shkuarës.

5. Është pra thelbësore që të bëhet një progres i shpejtë për të korrigjuar çekuilibrat e brendshëm dhe të jashtëm. Ndërsa përshtatja në sektorin privat tashmë ka nisur, buxheti duhet të bëjë një kthesë domethënëse në mënyrë që të ulët deficieti i llogarisë korente dhe të krijohet hapësirë për kreditimin e sektorit privat. Politikat monetare dhe ato të sektorit financiar duhet të mbeten të matura për të përballuar rreziqe të reja, ndërsa mjedisi i biznesit duhet të përmirësohet më tej në mënyrë që të thithen investimet e nevojshme si nga brenda dhe nga jashtë Shqipërisë.

***Ribalancimi i rritjes në një mjedis të jashtëm që po përmirësohet ngaladë dhe pëballë rreziqeve të konsiderueshme...***

6. Skenari bazë është për një rikuperim në formë V-je, ndonëse në një nivel më të ulët të rritjes potenciale pas periudhës së bumit. Pas një reduktimi të vlerësuar të PBB-së në tremujorin e katërt të 2009, parashikohet që rritja me norma të ulëta të rifillojë në tremujorin e parë të 2010 dhe më pas gradualisht të forcohet, me një normë vjetore të rritjes së PBB-së në intervalin 2 – 2½ përqind në 2010. Kjo kryesisht pasqyron zhvillimet në ndërtim dhe në disa sektorë të shërbimeve, me gjithë tkurrjet në kreditim dhe në kërkesë. Në periudhën afatmesme, rritja duhet të jetë në gjendje të arrijë potencialin, i cili gjithsesi do të jetë disi më i ulët se i vënë re gjatë periudhës së bumit në dekadën e kaluar. Rritja e çmimeve të administruara mund të rrisë inflacionin përtej intervalit të synuar 3±1 përqind në afatin e shkurtër. Gjithsesi, inflacioni bazë pritet të mbetet nën kontroll, dhe inflacioni vjetor parashikohet në 3.4 përqind në 2010 dhe 3 përqind në periudhën afatmesme. I ndihmuar nga nënçmimi i kohëve të fundit i kursit të këmbimit, deficieti i llogarisë korrente mund të ngushtohet nga 15 në 13 përqind këtë vit, pasi konsumi privat vazhdon të përshtatet dhe duhet të bjerë akoma në periudhën afatmesme për të arritur një nivel të qëndrueshëm.

7. Rreziqet ndaj këtij parashikimi janë sidoqoftë domethënëse. Përveç rreziqeve që vijnë nga mjedisi i jashtëm, cënueshmëritë e brendshme mbeten. Një pjesë e madhe e borxhit të brendshëm publik duhet të rrefinancohet çdo muaj, ndërsa programi i privatizimit nuk ka shumë gjasa të gjenerojë të ardhura domethënëse. Bankat gjithashtu duhet të përshtaten me parashikimin e ri, duke marrë në konsideratë kërkesën më të dobët për kredi, përkeqësimin e portofoleve të kredisë dhe normat më të ulëta të fitimit që do të rezultojnë. Besimi i dobësuar i familjeve dhe ndërmarrjeve mund të ulë konsumin dhe investimet më shumë se sa pritet.

*...dhe buxheti mban barrën më të madhe për përshtatje*

8. Tkurrrja fiskale duhet të vihet në zbatim shpejt pasi rigjallërimi optimist dhe i shpejtë i parashikuar në buxhetin e 2010 dhe në kuadrin fiskal afatmesëm ka pak gjasa të ndodhë. Megjithë shkurtimet domethënëse në buxhetin e 2010 të propozura në Kuadrin e Ri Markoekonomik Afatmesëm të qeverisë—rreth 30 miliardë Lekë ose 2.5 përqind e PBB-së—prirjet aktuale të të ardhurave nënkuptojnë një defiçit prej 5.6% të PBB-së. Rishikimi i buxhetit në muajt e ardhshëm duhet të synojë të ulë defiçitin në rreth 3 përqind të PBB-së. Kjo do të ulë kërkesën për financime, do të mbështesë përshtatjen e llogarisë korrente dhe do të shënojë hapin e parë drejt bërjes të besueshme dhe të arritshme të objektivit të përshtatshëm të qeverisë për ta ulur borxhin publik përsëri në 50% të PBB-së në fund të mandatit të saj në 2013. Si rritja e të ardhurave, ashtu dhe shkurtimet e shpenzimeve duhet të jenë në axhendë.

- Pritshmëritë për të ardhurat duhet akoma t'i përshtaten një mjedis post-bum më pak të bollshëm. Si në pjesën më të madhe të Europës Lindore dhe në rajon, të ardhurat nga taksat kanë rënë, pasi baza e taksave u rrit gjatë periudhës së bumit—sidomos nga importet shumë të larta, konsumi dhe çmimet e pasurive të paluajtshme—por tashmë ato po përshtaten në nivele të reja më të ulëta të përhershme. Prandaj, uljet e taksave dhe kontributeve në të shkuarën që bazoheshin në bumit e rritjes së të ardhurave duhet të rishikohen. P.sh. ka pak prova se ulja e normës së kontributeve të sigurimeve shoqërore vitin e kaluar ka përmirësuar pagesat siç pritej atëherë, ndërsa nga ana tjetër, ka përkeqësuar defiçitin e pensioneve në 2.5% të PBB-së, një nivel i lartë po të merret parasysh konteksti i Shqipërisë me një popullsi relativisht të re. Ndonëse është tunduese në klimën aktuale—duke qenë se ka mundësinë për një rritje të njëhershme në të ardhura—një amnisti fiskale duhet marrë në konsideratë vetëm si mjete i fundit, pasi rrezikon të kërcënojë pagesat e taksave në të ardhmen dhe besueshmërinë e sistemit tatimor.
- Rritja e kohëve të fundit në shpenzime ka hedhur dyshime mbi aftësinë e qeverisë për të mbajtur një sektor publik të vogël. Në situatën e tanishme, kjo kërkon që të mos shpenzohet sasia e mbetur e kontigjencave prej 0.4% të PBB-së në buxhetin e 2010. Ajo që është më thelbësore dhe me një efekt më afatgjatë, është e rëndësishme që investimet publike të sillen përsëri në nivele më të financueshme dhe më të menaxhueshme nga ana administrative pas përfundimit të rrugës Rrëshen-Kalimash. Po aq e rëndësishme është që shpenzimet korrente të rishikohen me synim për të optimizuar shërbimin civil dhe për të mbajtur pagat dhe pensionet nën kontroll. Këtë situatë mund t'a ndihmonte indeksimi i këtyre të fundit vetëm me inflacionin.

9. Duke parë mbështetjen e madhe në financime të brendshme afatshkurtra, me shumë vend autoritetet po kërkojnë të emetojnë një Eurobond. Megjithatë, rritja e pasigurisë në tregjet ndërkombëtare mund të ketë një ndikim në sasinë dhe në çmimin e emetimit, ndaj autoritetet këshillohet që të mbajnë hapur dhe mundësi të tjera.

10. Politikat fiskale afatmesme duhet të udhëhiqen nga një rregull fiskal i besueshëm dhe i monitorueshëm. Kufizimi i rritjes reale të shpenzimeve në 2 përqind mund të arrijë reduktimin e sipërpërmendur të borxhit në 50 përqind të PBB-së në 2013. Do të ishte e preferueshme që ky rregull të përforcohej me një mekanizëm që do të ulte rritjen e shpenzimeve në rast se ka rënie të paparashikuar në nivelin e të ardhurave. Në të kundërt, tejkalimet në të ardhura do të përktheheshin në kursime fiskale, çka do të ulte rrezikun për tejkalimin e kufirit të borxhit.

***Të ndihmohet sistemi financiar për të përballuar sfidat e reja***

11. Mbikqyrësit e sektorit financiar do të duhet të vazhdojnë të qëndrojnë në ballë rreziqeve dhe sfidave në zhvillim. Mbikqyrja e fortë në të kaluarën ka sjellë fryte gjatë krizës globale, pasi bankat mundën të mbështeteshin në rezerva të mëdha kapitali dhe likuiditeti për të kaluar stuhinë. Megjithatë, rreziqe të reja po dalin, sidomos tani që më shumë kredi në bilancet e bankave pritet që të përkeqësohen, ndërkohë që flukset hyrëse të kapitalit do të mbeten të ngadalta. Në këtë kontekst, mbikqyrësit duhet të vazhdojnë të monitorojnë zhvillimet nga afër dhe në mënyrë të vazhdueshme, të hartojnë plane kontigjence për t'u përballuar rreziqet me probabilitet të ulët por pasoja të rënda, dhe të përshtasin instrumentat makro-prudenciale për të përballuar çdo rrezik në zhvillim ndaj stabilitetit financiar që në fillim, duke hedhur kështu themelet për një rifillim të qëndrueshëm të rritjes së kredisë. Bankat do të duhet të ndihmojnë ristrukturimin e gjerë të ekonomisë dhe korrektimin e çmimeve të pasurive të paluajtshme, duke ekzekutuar agresivisht kolateralin për kreditë e pakthyeshme.

12. Kuadri i politikave monetare dhe kursi i luhatshëm i këmbimit i kanë shërbyer mirë ekonomisë. Ndaj ne e inkurajojmë Bankën e Shqipërisë për të vazhduar me këtë qëndrim të kujdeshëm, me një fokus të fortë në ankorimin e pritshmërive për inflacionin. Ndërsa vendimet për normat e interesit duhet të orientohen nga zhvillimet aktuale dhe të pritshme të inflacionit në krahasim me objektivin e synuar, hartuesit e politikave monetare duhet të mbajnë parasysh konsideratat e stabilitetit financiar dhe nevojat makro-prudenciale.

***Reformat strukturore duhet të zëvendësojnë stimulin makroekonomik për të siguruar rritje afatmesme***

13. Në të ardhmen, ekonomia shqiptare duhet të zgjerojë burimet e rritjes dhe të forcojë konkurrueshmërinë. Kjo kërkon përmirësime të shpejta në mjedisin e biznesit dhe në mbrojtjen e investitorëve për të sjellë më shumë investime vendase dhe të huaja, për të rritur produktivitetin e Shqipërisë dhe për të ndihmuar eksportet shqiptare që të ngjisin shkallën e vlerës së shtuar. Prioritetet për veprim janë: hendeku i konsiderueshëm i zbatimit të rregullave formale, mungesa e sigurisë për të drejtat e pronësisë (përfshirë pronësinë e tokës), dhe ekonomia informale. Burimet e financimit për të tilla investime mund të rriten nga gjetja e investitoreve të rinj institucionalë, si p.sh. nëpërmjet përsheptimit të reformës së pensioneve.

14. Suksesi i privatizimeve të shkuara ka nevojë për kujdes për të pritur eficientë e shpresuar dhe për të ruajtur reputacionin e përmirësuar të Shqipërisë për investime të mëdha. Në këtë kontekst, ne inkurajojmë zgjidhjen e shpejtë të çështjeve rregullatore që i përkasin OSSH-së. Përveç kësaj, pas privatizimit ARMO ka patur vonesa në shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe ato me ndërmarrjet e tjera, gjë që e vë në rrezik privatizimin e suksesshëm të Albpetrolit—pra dhe përfundimin e programit të privatizimeve strategjike. Ne rekomandojmë që Albpetroli të ndërmarrë hapa ligjorë për të rikuperuar detyrimet e pashlyera që i ka ARMO-s.

15. Statistikat makroekonomike të shëndosha janë thelbësore për një politikë-bërje të aftë dhe për besimin e investitorëve. Agjencia kombëtare e statistikave INSTAT ka bërë progres të jashtëzakonshëm në vitet e fundit, p.sh. duke filluar me publikimin e llogarive kombëtare tremujore dhe duke përmirësuar vazhdimisht cilësinë e tyre. Megjithatë, ka hapësirë të konsiderueshme për përmirësim të mëtejshëm. Në mënyrë të veçantë, autoritetet duhet të konsiderojnë një rritje të ndjeshme të burimeve për INSTAT-in, me qëllim që të rritet cilësia e burimeve të të dhënave të disponueshme—jo vetëm jashtë administratës publike, por edhe brenda saj—si dhe për të lehtësuar përpunimin e të dhënave, menaxhimin dhe analizën. Qëllimi për t'u regjistruar në SDDS (standarti i veçantë i përhapjes së të dhënave) i FMN-së është për t'u përshëndetur.

\*\*\*

Ne i falenderojmë autoritetet për bashkëpunimin e shkëlqyer dhe mikpritjen e ngrohtë.